



A.nr.325/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabanin, anëtarë, me Merlinda Ramaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës më numër A.nr.325/2026, të datës 23.03.2026, të parashtruar nga ankuesi N.K, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokate Valentina Kaçandolli-Bekteshi, nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me 13.08.2026, nxjerrë këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa më numër A.nr.325/2026, e datës 23.03.2026, e parashtruar nga ankuesi N.K.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, N.K (*në tekstin e mëtejme referuar: ankuesi*) më datë 23.03.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kundërshtuar emërimin e nëpunësit civil z. M.R Udhëheqës i Sektorit të Inspektimit për Pylltari, më pretendimin së avancimi i tij ka shkelur të drejtat e tij të avancimit të ankuesit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 26.03.2026 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ndërsa, kjo e fundit, ka dërguar përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) duke ju referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa e parashtruar nga ankuesi me datë 23.03.2026 është e *palejuar, sepse:*

I. Gjendja e fakteve

Nga shqyrtimi i provave të administruara rezulton:

-Ankuesi sipas Akt emërimit me numër protokolli 2770 të datës 26.08.2025, ushtron pozitën e punës *Inspektor për Silvikulturë Mbrojtje të Pyjeve dhe Gjueti*, në Departamentin Qendror i Inspektionit për Pylltari dhe Gjueti.

-Më datë 27.06.2025, ankuesi ka përcjell një shkresë me titull njoftim tek Sekretarja e Përgjithshme në MBPZHR, lidhur me paligjshmërinë e Vendimit me numër Ref: DP-APK-703/2015 të datës 03.09.2015, për transferimin e përhershëm të nëpunësit civil z.M.R, nga pozita Inspektor i Pylltarisë në DQIPGJ-APK në pozitën e punës Udhëheqës i Sektorit të Inspektionit për Pylltari në Drejtoratin Qendror të Inspektionit të Pylltarisë dhe Gjuetisë në APK.

- Kundër heshtjes në njoftimin e datës 27.6.2025, ankuesi më datë 10.10.2025 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa, ky i fundit më Vendimin A.nr. 1785/2025, të datës 14.01.2026, ka aprovuar ankesën e ankuesit dhe ka detyruar Sekretaren e Përgjithshme në MBPZHR, që të shqyrtojë kërkesën e datës 27.06.2025, të parashtruar nga ankuesi dhe të nxjerrë akt administrativ.

- Sekretarja e Përgjithshme në MBPZHR, bazuar në Vendimin me numër 1785/2025 të datës 14.01.2026 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i'u është përgjigjur ankuesit në kërkesën e datës 27.06.2025, duke theksuar se nuk ka mandat shqyrtimin e çfarëdo ankese lidhur me vendimet e ndërmarra nga Agjencia Pyjore e Kosovës, e aq më pak vlerësimin e ligjshmërisë së procedurave të avancimit apo cilëndo procedurë tjetër që ndërlidhet me marrëdhënien e punës.

-Ankuesi, përmes Kërkesës me numër të protokollit 215/2 të datës 30.01.2026, ka njoftuar U.d. Drejtorin Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës, lidhur me paligjshmërinë e Vendimit me numër Ref: DP-APK-703/2015 i datës 03.09.2015, për transferimin e përhershëm të nëpunësit civil z.M.R, nga pozita Inspektor i Pylltarisë në DQIPGJ-APK në pozitën e punës Udhëheqës i Sektorit të Inspektionit për Pylltari në Drejtoratin Qendror të Inspektionit të Pylltarisë dhe Gjuetisë në APK.

-U.d. Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Pyjore të Kosovës, me datë 10.03.2026, në përgjigje të kërkesës së ankuesit të datës 30.01.2026 ka bërë të ditur ankuesin se Agjencia Pyjore e Kosovës nuk ka kompetencë institucionale për të vlerësuar apo për të vendosur lidhur me statusin aktual të asnjë zyrtari brenda strukturave të MBPZHR-së, si dhe nuk ka kompetencë për të ndërhyrë në marrëdhëniet e punës të zyrtareve që tashmë janë të sistemuar me akt emërimet përkatëse në kuadër të Ministrisë.

II. Pretendimet Ankimore

Ankuesi serish parashtron ankesë në Këshill duke kontestuar avancimin e nëpunësit civil z. M.R sipas Vendimit me numër Ref: DP-APK-703/2015, të datës 03.09.2015, për transferimin e përhershëm nga pozita Inspektor i Pylltarisë në DQIPGJ-APK në pozitën e punës Udhëheqës i Sektorit të Inspektionit për Pylltari në Drejtoratin Qendror të Inspektionit të Pylltarisë dhe Gjuetisë në APK. Pretendon se i janë cenuar të drejtat e avancimit dhe ky veprim është diskriminues për ankuesin, duke shkelur nenin 7 dhe 17 të Ligjit për Zyrtarët Publik, nenin 4, 6, 7 dhe 9 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Kërkon që të aprovohet ankesa dhe të anulohet Akt emërimi i leshura nga Sekretarja e Përgjithshme e MBZHR për nëpunësin M.R i sistemuar në pozitën e Udhëheqës i Sektorit të Inspektionit për Pylltari.

III. Vlerësimi i Kolegjit

Në kuptim të lejueshmërisë së ankesës, Kolegji i Këshillit thekson faktin se në kohën e nxjerrjes së Vendimit me numër Ref: DP-APK-703/2015 të datës 03.09.2015, për transferimin e përhershëm të nëpunësit civil z. M.R, ka qenë në fuqi Ligji Nr.03/L-149 për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës i aplikueshëm deri 09 korrik 2020, andaj, në rast të pretendimit të palës ankuese se më këtë vendim i janë cenuar të drejtat dhe interesat e tij nga marrëdhënia e punës gjegjësisht të avancimit ashtu siç pretendohet me ankesë, atëherë ankuesi ka poseduar të drejtën e kundërshtimit të këtij veprimi në pajtim me nenin 81 të Ligji Nr.03/L-149 për Shërbim Civil dhe nenin 4 dhe 11 të Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, dispozita më të cilat përcaktohej: Neni 81 i LSHC : *1. Organe të veçanta për zgjidhjen e kontesteve të punësimit dhe të ankesave në shërbimin civil do të themelohen në kuadër të secilit institucion të administratës qendrore dhe komunale, që ka nëpunës civilë. 2.Procedurat për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave zhvillohen nga këto organe: 2. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; dhe 2.2. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës. Rregullorja Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave Neni 4: 1 nëpunësit civilë kanë të drejtë për ankesë kundër vendimit administrativ apo çdo shkelje apo lëshim të rregullave ose procedurave të përgjithshme administrative, që ndikojnë dhe kanë të bëjnë me marrëdhënien e tyre të punës", Neni 11: Kundër vendimit të Komisionit, palët e pakënaqura kanë të drejtë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, brenda afatit prej 30 ditësh.*

Rrjedhimisht, në kuptim të kuadrit ligjor si me lartë, ankuesi fillimisht Vendimin me numër Ref: DP-APK-703/2015 të datës 03.09.2015, mund ta kontestonte pranë Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave që themelohej pranë çdo institucioni dhe me pastaj në rast të pakënaqësisë më vendimin e KZKA-së ka poseduar të drejtën e ankesës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit të KZKA-së. Pra, duke qenë se ankuesi nuk kishte ndërmarr asnjë veprim juridik në afatet e përcaktuar ligjore për të kundërshtuar aktin në fjalë, atëherë, mbi këtë bazë, ushtrimi i ankesës më datë 23.03.2026, mbi bazën e pretendimeve si më sipër, është e papranueshme në kuptim të nenit 129, paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.05/L- 031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

KËSHILLË JURIDIKE: Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda : A.nr.325/2026

Merlinda RAMAJ

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit, avokate, *Valentina Kaçandolli-Bekteshi*;
- Sekretares së Përgjithshme dhe Udhëheqëses së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore
- Arkivit të KPMSHCK-së.